



DISKUTIME MBI PROJEKTLIGJIN “PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”

Diskutimet kryesore në takim përfshinin nene të veçanta që lidhen me drejtimin e shoqërive me një apo dy nivele, mënyrat e vlerësimit nga AMF e kërkesave për përshtatshmëri dhe aftësi të aksionarëve e funksionarëve kryesorë në shoqërinë e sigurimit si edhe çështje të lidhura me përmbajtjen e kontratës së sigurimit.

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për muajin shkurt 2012

Buletini Statistikor për muajin shkurt 2012, përmban pasqyra të detajuara të ndarjes së Tregut të Sigurimeve, sipas llojit të sigurimit, produkteve të sigurimit, pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimit në treg, etj.

Vijon në faqen 3

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve private dhe roli i tyre në edukimin financiar
(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e OECD-së, nëntor 2011)

Vijon nga numri i kaluar

(Në numrin e kaluar ju lexuat informacionin mbi edukimin financiar dhe krizën, me shembuj nga vende si: Italia e Maqedonia, si dhe fushatat e edukimit financiar nga autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve. Në rastin e Turqisë ju lexuat se si mund të përdoret kontakti i drejtpërdrejtë me anëtarët e fondeve përmes vrojtimeve, në mënyrë që të ngrihen, orientohen dhe përmirësohen programet e edukimit financiar.)

Vijon në faqen 3

ZHVILLIME TË TJERA

Trajnim pranë AMF-së mbi çështjet aktuariale me mbështetjen e Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare, FSVC, USAID.

Vijon në faqen 8

“Fleksibiliteti i siguruesve në një botë financiare që po ndryshon” trajnim nga Instituti për Stabilitetin Financiar, Bazel, Zvicër

Vijon në faqen 8

Konferencë vjetore për ligjin evropian të sigurimeve, organizuar nga Akademia Evropiane e Ligjit (ERA), Trier, Gjermani

Vijon në faqen 9

“Kordinimi i politikave dhe stabiliteti financiar”, takim i organizuar nga Qendra e Ekselencës Financiare (ECF) e Ministrisë së Financave, Slloveni

Vijon në faqen 10

“Bazat e Marrëveshjes së Përgjithshme të Tregtisë në Shërbime”, seminar i organizuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në Tiranë

Vijon në faqen 10

TË REJA NGA RAJONI

Slloveni: Reflektime mbi Tregun e sigurimeve gjatë 2011

Vijon në faqen 11

Rumani: Sigurimi i Jetës dhe i Pronës dinamike pozitive gjatë 2011

Vijon në faqen 12

DISKUTIME MBI PROJEKTLIGJIN “PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”

Nga komentet e Shoqatës së Siguruesve janë reflektuar rreth 26 komente për nene të veçanta të ligjit që janë sjellë nga kjo shoqatë.

Në datë 29 mars 2012, AMF zhvilloi një takim të zgjeruar me një nga grupet e interesit, Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë, për projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit” në Shqipëri. Projektligji realizon një përshtatje më të mirë të zhvillimeve të reja të tregut me legjislacionin evropian duke sjellë mjaft risi si në drejtim të mbrojtjes sa më efektive të konsumatorit, mbikëqyrjes me fokus riskun dhe rregullat e qeverisjes së shoqërive të sigurimit me theks të veçantë në menaxhimin e riskut.

që janë sjellë nga kjo shoqatë. Ndërkohë nuk janë gjykuar të përshtatshme për t’u përfshirë në ligj komentet e ardhura, të



Gjatë diskutimit mbi projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”



*Nga e majta në të djathtë:
Zj. Enkeleda Shehi, Kryetare e AMF-së;
Zj. Viola Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike; Zj. Teuta Cani, Drejtore e Drejtorisë së Rregullimit dhe Standarteve dhe Zj. Fatbardha Hebovija, Drejtore e Drejtorisë së Zbatueshmërisë*

Në periudhën janar - shkurt 2012, AMF trajtoi komentet nga grupet e interesit, shoqëritë e sigurimeve, duke shqyrtuar me kujdes gjithë komentet e dërguara nga Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë rreth projektligjit. Janë reflektuar rreth 26 komente për nene të veçanta të ligjit

cilat nuk janë në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian apo që nuk lidhen me mbrojtjen e konsumatorit.

Ndër çështjet më të diskutuara gjatë takimit përmendim: Mënyra e qeverisjes së shoqërisë së sigurimit me një nivel drejtimi apo me dy nivele, mënyra e vlerësimit nga AMF e kërkesave për përshtatshmëri dhe aftësi të aksionarëve dhe funksionarëve kryesorë në shoqërinë e sigurimit, çështje lidhur me përmbajtjen e kontratës së sigurimit, çështja e trajtimit të provigjonit të barazimit të dëmeve si pjesë e kapitalit, llogaritja e likuiditetit me bazë ditore, mbajtja e kontabilitetit, si dhe trajtimi i gjobës si titull ekzekutiv.

Autoriteti është ende në proces shqyrtimi edhe të rekomandimeve të institucioneve të tjera, dhe do t’i rishikojë dhe një herë këto çështje për të parë mundësinë e përfshirjes së tyre në projektligj.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për muajin shkurt 2012

<http://amf.gov.al/news.asp?id=668>

Buletini Statistikor për muajin shkurt 2012, përmban pasqyra të detajuara të ndarjes së Tregut të Sigurimeve,

sipas llojit të sigurimit, produkteve të sigurimit, pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimit në treg, etj.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve private dhe roli i tyre në edukimin financiar

(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e OECD-së, nëntor 2011)

http://www.oecd.org/document/8/0,3746en_2649_15251491_41210376_1_1_1_1,00.html

Vijon nga numri i kaluar

(Në numrin e kaluar ju lexuat informacionin mbi edukimin financiar dhe krizën, me shembuj nga vende si: Italia e Maqedonia, si dhe fushatat e edukimit financiar nga autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve. Në rastin e Turqisë ju lexuat se si mund të përdoret kontakti i drejtpërdrejtë me anëtarët e fondeve përmes vrojtimeve, në mënyrë që të ngrihen, orientohen dhe përmirësohen programet e edukimit financiar.)

Mësimet e nxjerra nga IOPS

Materiali i punës i IOPS-it propozon rekomandimet e mëposhtme për autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve:

- Të japin informacion bazë përmes fletëpalosjeve e materialeve të tjera promovionale;
- Të japin informacion përkatës përmes hapësirave në internet, të cilat janë identifikuar si instrumente me efikasitet të lartë të koston, sa i takon kohës dhe numrit të individëve të arritur;
- Të aprovojnë materialet e trajnimit që ofrojnë institucionet e tjera, të cilat kërkojnë të plotësojnë punën e tyre;
- Të bëjnë punë kërkimore për të matur nevojat e tyre, në mënyrë që të mund të përshtatin materialin edukativ për t'i plotësuar këto nevoja, si dhe;
- T'i edukojnë grupet e interesit për çdo ndryshim rregullator që prek këtë sektor ekonomik, cilado qofshin këto ndryshime.

Krahas këtyre mësimëve, një analizë e programeve ekzistuese sugjeron këto rekomandime, si vijon:

- Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve mund të mendojnë idenë e orientimit të fushatave drejt anëtarëve të fondeve të pensioneve kur këta të jenë të rinj në moshë, e jo kur janë në prag të daljes në pension;
- Është mirë të tregohet kujdes me llojin e gjuhës që përdoret, në mënyrë që të mos krijohen stereotipa dhe të mos stigmatizohen pensionistët;

Materiali i OECD-së thekson në mënyrë të veçantë, se “krizat financiare kërkojnë rritje të komunikimit lidhur me investime me kontribute të përcaktuara”.

- Mund të përdoren mekanizma novatorë dhe interesantë për komunikimin me të rinjtë, siç janë lojërat dhe hapësirat në internet;
- Të përdoren përvojat individuale për të arritur që mesazhi të përcillet mirë;
- Të përdoren vrojtimet për të ndihmuar në orientimin dhe përshtatjen në mënyrë të efektshme të programeve të punës afruese dhe edukimit financiar.

Mësimet nga puna e OECD-së në edukimin financiar

Krahas mësimëve të nxjerra në mënyrë specifike nga ky material, ia vlen të vërehen edhe rekomandime të tjera dhe praktikat e mira të OECD-së, të cilat mund të zbatohen edhe nga fushatat e zhvilluara nga autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve.

- Edukimi financiar duhet të ofrohet në mënyrë të drejtë dhe pa shtrembërime.
- Programet duhet të bashkërendohen dhe përgatiten me efikasitet.
- Programet duhet të përqendrohen te çështjet me prioritet të lartë. Në varësi të kushteve të vendit, kjo mund të përfshijë aspektet thelbësore të planifikimit financiar të jetës, siç janë kursimet bazë, administrimi i borxhit vetjak dhe sigurimet. Krahas kësaj, kjo mund të përfshijë parakushtet për ndërgjegjësimin financiar, siç janë njohuritë elementare të matematikës financiare dhe ekonomisë. Është mirë të nxiten ata që do të dalin në pension në të ardhmen, të vlerësojnë nivelin financiar të skemave ekzistuese publike dhe private të pensioneve ku marrin pjesë dhe të marrin masat e duhura sipas rastit.
- Duhet nxitur fushatat kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit të

individëve lidhur me nevojën për të përmirësuar njohuritë për risqet financiare dhe për mënyrat me të cilat mund të mbrohen nga këto risqe, nëpërmjet kursimeve, sigurimeve dhe edukimit financiar adekuat.

- Edukimi financiar duhet të fillojë që në shkollë. Njerëzit duhet të edukohen për çështjet financiare sa më herët në jetë.

Sa u takon pensioneve në veçanti, **OECD jep rekomandime specifike lidhur me rolin e qeverive**, duke theksuar se ato:

- Kanë një rol të ndjeshëm për të luajtur në programet e edukimit financiar për pensionet, përmes fushatave të ndërgjegjësimit të publikut. Ato duhet të ofrojnë një rol të fuqishëm udhëheqës, duke i bashkërenduar projektet me një varg partnerësh të tjerë.
- Duhet ta shpjegojnë qartë politikën publike (sidomos kur kjo ka të bëjë me kursimet e detyrueshme), duke përfshirë reformën e pensioneve, mjedisin e pensioneve, rritjen e përgjegjësisë individuale dhe ndryshimet demografike, të cilat u kërkojnë individëve të kursejnë më shumë. Kjo do të ndihmojë në ruajtjen e transparencës dhe besimit të sistemi i pensioneve dhe do t'i nxisë kështu individët të kursejnë për pensionin e pleqërisë. Por, duhet treguar kujdes me fushatat publike, për të bërë dallimin midis edukimit financiar dhe mbrojtjes politikisht të një forme të caktuar sistemi për pensionet e pleqërisë.
- Duhet t'i orientojë fushatat e ndërgjegjësimit publik sa më gjerë, për shkak të mungesës së përhapur të njohurive për çështjet

e pensioneve. Krahas kësaj, ndikim të ndjeshëm mund të kenë edhe programet specifike, të cilat synojnë shumicën e grupeve të pambrojtura, siç janë migruesit dhe ata me të nivele me të ulëta të të ardhurave dhe kursimeve.

- Duhet të japin informacion për burimet marrjessë informacioneve dhe këshillave të tjera lidhur me zbutjen e risqeve.

Materiali i OECD-së thekson në mënyrë të veçantë, se “krizat financiare kërkojnë rritje të komunikimit lidhur me investime me kontribute të përcaktuara”. Krahas kësaj, mesazhet e tjera të nxjerra nga analiza e këtyre fushatave, të cilat janë aktuale, pavarësisht nëse realizohen nga autoritete mbikëqyrëse të pensioneve apo nga institucione të tjera publike, janë:

- **Objektivat e qarta dhe të matshme janë shtytës të fushatave të suksesshme** - Aspekti më i rëndësishëm i çdo fushate komunikimi janë objektivat. Objektivat e qarta dhe të matshme i shtyjnë përpara me sukses proceset e planifikimit, vënies në zbatim dhe vlerësimit.
- **Nevoja për procese të fuqishme vlerësimi** - Vlerësimi duhet të përbëjë një element thelbësor të buxhetit të fushatës edhe atëherë kur burimet janë të kufizuara. Përfshirja e vlerësimit në planifikimin e fushatave do t’u japë mundësi organizatorëve të analizojnë ndikimin e fushatës dhe analizën kosto-përfitim, në mënyrë që të sigurohet shpërndarja e duhur e burimeve të ardhshme. Kjo do t’u japë mundësi organizatorëve t’i testojnë objektivat në një fazë të hershme për të siguruar që të jenë

praktikë dhe të mund të maten në një mënyrë që të ketë kuptim. Procesi i vlerësimit duhet të përfshijë punë kërkimore përpara fushatës dhe monitorim-vlerësim të rregullt të fushatës përmes instrumenteve sasiore dhe cilësore.

Strategjia Kombëtare për edukimin financiar

Puna për edukimin financiar e OECD-së dhe Rrjetit Ndërkombëtar për Edukimin Financiar (INFE) vazhdon të theksojë se veprimi në këtë fushë nga aktorët individualë (siç janë autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve) nuk duhet të konsiderohet e veçuar ose duhet të shihet brenda një perspektive më të gjerë. Kjo mund të përfshijë në fushën e pensioneve bashkërendimin me rregullatorët e pensioneve, ofruesit e fondeve të pensioneve, paguesit e kontributeve, etj. Për edukimin financiar është i rëndësishëm akumulimi i programeve të ndryshme (shpesh bien ndesh me njëri-tjetrin). Ky problem bëhet më i mprehtë sidomos kur nuk u bëhet analizë vlerësuese të programeve.

Në një material të shkurtër, INFE thekson se, sidomos pas krizës financiare, ndërgjegjësimi për rëndësinë e edukimit financiar ka fituar më shumë vëmendje mes vendimmarrësve për politikë. Kjo ka çuar vitet e fundit në hartimin e një numri në rritje të strategjive të përshtatura, të cilat shpesh janë ndërthurur me një theks më të madh kombëtar të mbrojtja e konsumatorëve të shërbimeve financiare dhe masat përfshirëse.

Raporti analizon se vendet të cilat i kanë miratuar tashmë këto strategji, i kanë kapërcyer vështirësitë e ndryshme, që nga mungesa e burimeve, vështirësia e identifikimit të udhëheqësit të

Pas krizës financiare, ndërgjegjësimi për rëndësinë e edukimit financiar ka fituar më shumë vëmendje mes vendimmarrësve për politikë.

strategjisë deri te ruajtja e angazhimit afatgjatë dhe kalimi me efikasitet drejt fazës së vënies në jetë.

Raporti i INFE-së plotësohet me një projekt-material me titull “Parimet e nivelit të lartë për strategjinë kombëtare për edukimin financiar”, në të cilin përfshihen këto rekomandime:

- **Përgatitja e Strategjisë Kombëtare** - preferohet të udhëhiqet nga qeveria, një autoritet publik a rregullator ose nga një organ kombëtar këshillimor/drejtues.
- **Identifikimi dhe vlerësimi i nismave ekzistuese** - faza përgatitore duhet të përfshijë identifikimin dhe shqyrtimin e nismave ekzistuese për edukimin financiar të promovuara nga palë interesi publike, private dhe civile.
- **Vlerësimi i nevojave të popullsisë dhe çështjet kryesore të politikave** - është mirë të bëhet edhe një vlerësim i niveleve të njohurive financiare të popullsisë dhe i çështjeve kryesore të lidhura të politikave, për të përcaktuar më mirë objektivat kryesorë afatshkurtër dhe afatgjatë të strategjisë kombëtare.
- **Konsultimet** - është mirë të mendohet, gjatë kësaj faze përgatitore edhe për identifikimin e një mekanizmi ose të disa mekanizmave për të siguruar këshillimin dhe bashkërendimin ndërmjet palëve të ndryshme të interesit (mundësisht duke përfshirë edhe publikun e gjerë).
- **Ndërgjegjësimi dhe komunikimi kombëtar** - duhet promovuar intensivisht raportimi dhe komunikimi vendimtar i rezultateve të kësaj faze përgatitore dhe njoftimi publik zyrtar i përgatitjes së një strategjie kombëtare tek palët e interesit dhe publiku, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë

e kësaj sipërmarrjeje dhe të rritet mbështetja nga grupet kyçe të interesit.

- **Qeverisja dhe roli i grupeve të interesit** - korniza e strategjisë kombëtare duhet përshtatur sipas rrethanave të vendit. Në të njëjtën kohë, ajo duhet të mbështetet në një mekanizëm të qeverisjes transparente me një udhëheqës a organ udhëheqës të identifikuar dhe me role e përgjegjësi të përbashkëta por të qarta të grupeve të interesit.
- **Hartimi i dokumentit orientues me piketa** - korniza e strategjisë kombëtare duhet të përfshijë hartimin e një dokumenti të përshtatur udhërrëfyes, me objektiva realistë, të matshëm dhe me afate kohore, me instrumente të identifikuara për vlerësimin dhe me burime të përcaktuara.
- **Përmbajtja, mekanizmat e realizimit dhe instrumenteve** - korniza e strategjisë kombëtare dhe dokumenti udhërrëfyes mund të ofrojnë drejtimet për përmbajtjen e strategjisë dhe vënien e saj në zbatim, të identifikojnë grupet e synuara, prioritetet e politikave dhe të japin orientim për metodat dhe instrumentet e preferuara të realizimit. Këto drejtime duhet të jenë mjaftueshmërisht elastike dhe të marrin në konsideratë kuadrin dinamik të strategjisë kombëtare (duke përfshirë edhe mjedisin politik) dhe të përfshijnë studime dhe analiza të vazhdueshme për të siguruar aktualitetin e përmbajtjes.

Kundërpërgjigjet mbikëqyrëse ndaj krizës: Rritje e komunikimit dhe dhënies së informacioneve

Bullgaria: Në këtë fushë, FSC bashkëpunon me mediat, të cilave u dërgon publikime. Zëvendëskryetari i FSC-së, përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurimeve shoqërore, jep intervista

për këtë temë, në median e shkruar dhe elektronike. Në faqen zyrtare të FSC-së botohen fletëpalosje informuese. Synimi është të shpjegohen pasojat ekzistuese që ka kriza tek ecuria e investimeve të fondeve të pensioneve por edhe të theksohet natyra afatgjatë e kursimeve për pension. Sipas kërkesave ligjore, publiciteti dhe materialet informuese me shkrim të fondeve të pensioneve duhet të miratohen nga FSC. Çdo publikim i rezultateve të arritura të investimeve të një fondi pensionesh duhet të shoqërohet me një deklaratë ku thuhet se fondi nuk garanton kthime pozitive dhe se vlera e kuotave mund të bjerë.

Përgjithësisht, në Bullgari, çdo fond pensionesh është i detyruar që çdo vit, brenda datës 31 mars, të japë informacion për rezultatet vjetore të investimeve nga administrimi i një fondi pensionesh. Kjo duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Shkallën e kthimit të fondit të pensionit për secilin prej pesë viteve të fundit;
- Kthimin mesatar të llogaritur si mesatare gjeometrike të shkallëve vjetore të kthimit për secilin prej pesë viteve të fundit;
- Nivelin e riskut të investimit (devijimin standard të kthimit) për secilin prej pesë viteve të fundit;
- Raportin “Sharpe” të llogaritur sipas një formule të caktuar kur kthimi i arritur është më i lartë se shkalla me risk për vitin përkatës;
- Grafikon e vlerës së një kuote më ditën e fundit të punës të secilit muaj për secilin prej pesë viteve të fundit.

Hungaria: HFSA thekson rëndësinë e fluksit të duhur të komunikimit drejt anëtarëve të fondit të pensionit,

për të vendosur një filozofi të duhur të tolerancës ndaj riskut dhe për t'i rritur njohuritë e tyre për efektin e vendimeve kryesore për investimet dhe aftësinë paguese lidhur me gjendjen dhe ecurinë financiare të fondeve. Një prej fokuseve kryesore të HFSA-së në lidhje me komunikimin me fondet dhe anëtarët e fondeve, është sigurimi i dhënies së informacioneve shpjeguese, pra vendosja në dispozicion e të gjitha informacioneve të mjaftueshme.

Duke pasur parasysh emergjencën e krijuar nga kriza financiare botërore, HFSA miratoi një strategji të re për komunikimin, duke theksuar rëndësinë e dhënies së informacioneve shpjeguese për ecurinë e investimeve gjatë 10 viteve të fundit, duke përfshirë edhe një shpjegim të kthimeve të pakta gjatë deklaramit të tyre. Kjo nevojë lind edhe nga fluksi i munguar i komunikimit ndërmjet fondeve dhe anëtarëve të tyre, duke përfshirë këtu edhe informacionin e pamjaftueshëm nga fondet për anëtarët e tyre, në lidhje me vendimet e marra për zbutjen e humbjeve, si edhe njohuritë e pakta financiare të anëtarëve.

Italia: COVIP u ka kërkuar të gjitha fondeve t’u kujtojnë anëtarëve që dalin në pension se legjislacioni ekzistues u lejon ta mbajnë kapitalin e investuar në fondin e pensionit edhe pas daljes në pension, duke mundësuar kështu që të presin një përmirësim të kushteve të tregut përpara blerjes së një shume vjetore.

Polonia: Si rezultat i krizës, ka lindur rreziku i mbylljes të disa prej skemave të pensioneve profesionale. PFSA ka komunikuar me kontribuesit e skemave dhe me publikun e gjerë për natyrën afatgjatë të kursimeve për pension dhe i ka frenuar kontribuesit e skemave që të mos ndërmarrin veprime shumë radikale.

Sipas kërkesave ligjore, publiciteti dhe materialet informuese me shkrim të fondeve të pensioneve duhet të miratohen nga FSC.

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet trajnimi mbi çështjet aktuariale

Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme që FSVC i jep Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë periudhës 19-23 mars, u zhvillua një trajnim mbi çështje të ndryshme aktuariale.

Trajnimi u drejtua nga Dr. Murdza, anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve pa Kufij, që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e aktuaristikës që prej vitit 1914. Ky trajnim u zhvillua mbi bazën e pyetjeve e u diskutua në përputhje me standardet profesionale aktuariale. Falë

eksperiencës së gjatë të Dr. Murdza trajnimi rezultoi shumë i frytshëm për aktuarët e AMF-së, pasi qasje alternative dhe cilësore u paraqitën si zgjidhje të mundshme për çështjet e ngritura. Referenca të dobishme u vunë në dispozicion të specialistëve të AMF-së që do të mundësojnë zgjerimin e njohurive të tyre.

AMF vlerëson kontributin e dhënë nga eksperti i Shoqatës Ndërkombëtare të Aktuarëve pa Kufij si dhe nga FSVC, për përmirësimin dhe zhvillimin cilësor të praktikave të punës në Autoritet.

Fleksibiliteti i siguruesve në një botë financiare që po ndryshon

Instituti për Stabilitetin Financiar zhvilloi më 20 - 22 mars 2012 në Bazel, Zvicër, seminarin me temë “**Mbi fleksibilitetin e siguruesve në një botë financiare që po ndryshon**”. Në këtë seminar merrnin pjesë përfaqësues të autoriteteve të ndryshme rregullatore, anëtarë të Shoqatës Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Sigurimeve, IAIS (International Authority of Insurance Supervision).

Temat kryesore të trajtuara gjatë seminarit u prezantuan nga ekspertë të fushës së menaxhimit të riskut në sigurime dhe drejtues të nivelit të lartë të rregullatorëve të sigurimeve në botë. Prezantimet u përqendruan kryesisht në: Situatën aktuale, iniciativat dhe sfidat kombëtare në lidhje me regjimin e Solvency II, arkitekturën e re të mbikëqyrjes në BE dhe rolin e Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Vullnetare EIOPA (European Insurance and Occupational

Pensions Authority), shembuj të menaxhimit të riskut si pjesë e procesit të Solvency II në kompanitë Munich Re dhe Swiss Re, perspektivën e menaxhimit të riskut në kushtet e mbijetesës nga kriza financiare, si dhe kuadri ligjor për grupet në sigurime.

Në seminar u prezantua gjendja aktuale në lidhje me regjimin e Solvency II si reforma më e madhe e ndërmarrë për sigurimet në 30 vitet e fundit nga autoritetet rregullatore, anëtare të BE-së. Gjatë këtij prezantimi u theksua se lëvizja nga rregjimi Solvency I drejt Solvency II është shoqëruar me modernizimin e kuadrit rregullator për sigurimet në BE dhe në veçanti të kërkesave sasiore, cilësore, raportimit dhe transparencës ndaj mbikëqyrësve. Gjithashtu, lëvizja drejt Solvency II është shoqëruar edhe me ngritjen e një metodologjie mbikëqyrje, bazuar në identifikimin e vlerësimit e risqeve të siguruesve. Me ndryshimin e këtij rregjimi të llogaritjes së kapitalit,

Hyrja në fuqi për vendet e BE-së të Solvency II është shtyrë në datën 1 janar 2014, gjë që do të paraprihet nga përfundimi i kuadrit rregullator në 2012 dhe futjes së kërkesave të reja gjatë 2013.

synohet të përmirësohen sistemet e menaxhimit të riskut të siguruesve, të lejohen mbikëqyrësit të vlerësojnë më mirë profilet e riskut të siguruesve dhe përafrimin e metodologjisë mbikëqyrëse të vendeve të BE-së. Gjatë seminarit u theksua se për shkak të çështjeve të ngritura dhe për shkak të krizës financiare, hyrja në fuqi për vendet e BE-së të Solvency II është shtyrë në datën 1 janar 2014, gjë që do të paraprihet nga përfundimi i kuadrit rregullator në 2012 dhe futjes së kërkesave të reja gjatë 2013.

Gjatë Seminarit u prezantua historiku i reformës në strukturën e mbikëqyrjes së sektorit financiar në BE gjatë krizës financiare të viteve 2007 dhe 2008, i cili u finalizua me ngritjen Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Vullnetare, EIOPA (European Insurance and Occupational Pensions Authority) në janar 2011. Në seminar u prezantua struktura dhe roli i EIOPA-s në planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin e Solvency II dhe në veçanti në zhvillimin e udhëzimeve dhe standardeve teknike për mbikëqyrësit, drejtimin e punës për pyetësorët lidhur me kërkesat sasiore të Solvency II, këshillimin në diskutimet politike, etj.

Sa i përket perspektivës së menaxhimit të riskut në kushtet e mbijetesës nga kriza financiare, në seminar u theksua se menaxhimi i riskut duhet të integrojë në modelet e tij një probabilitet të arsyeshëm për ndodhjen e krizës, duke qenë i përgatitur në këtë mënyrë për këtë situatë. Gjithashtu është e rëndësishme që rregullimi i aftësisë paguese të jetë dinamik dhe të përshtatet ndaj krizave që ndodhin.

Në lidhje me kuadrin ligjor për grupet në sigurime, u prezantua iniciativa e IAIS-it Com Frame, e cila synon një mbikëqyrje më efektive për grupet në sigurime, një kuadër ligjor për mbikëqyrësit në lidhje me aktivitetin e grupeve në sigurime dhe përafrimin global të rregullimit dhe mbikëqyrjes së grupeve. Përfundimi i këtij kuadri rregullativ pritet në qershor të 2013. Gjatë prezantimit të kësaj teme u theksua se vështirësia në mbikëqyrjen e grupeve qëndron në strukturat e komplikuar, diversitetin e linjave të biznesit brenda grupeve, saktësinë e të dhënave në raportimet e konsoliduara, etj. Po punohet për kërkesat bazë, terminologjinë e përbashkët për kapitalin, së bashku me kërkesat për burimet e kapitalit.

Konferencë vjetore për ligjin evropian të sigurimeve

Akademia Evropiane e Ligjit (ERA) zhvilloi gjatë periudhës 5 - 6 mars, në Trier, Gjermani, konferencën vjetore mbi ligjin evropian të sigurimeve, me temë: “Një kontratë e përbashkët në fushën e sigurimeve, diskriminimi në fushën e sigurimeve dhe roli i avokatit financiar”. Në këtë konferencë merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore të Bashkimit Evropian, si dhe avokatë të fushës. Qëllimi i konferencës ishte informimi i juristëve të rinj në sigurime me problematikat dhe kërkesat e reja të hasura në këtë fushë.

Ndër temat kryesore të prezantuara nga drejtues të nivelit të lartë të organizatave të ndryshëm dhe profesorë të fushës së sigurimeve, përmendim:

- Reformat e ndërmarra në kontratat e sigurimeve të Mbretërisë së Bashkuar,
- Statusin aktual të realizimit të reformave të propozuara në ligjin e sigurimeve mbi Mbretërinë e Bashkuar, si dhe
- Prioritetet e reformës mbi ligjin e sigurimeve.

Qëllimi i konferencës ishte informimi i juristëve të rinj në sigurime me problematikat dhe kërkesat e reja të hasura në këtë fushë.

Gjithashtu u diskutua për zhvillimet e ligjit të sigurimeve dhe iniciativat, mbi kontratën e sigurimeve, për një kontratë të vetme Sigurimi Evropian, me qëllim që kjo mund të konsolidojë tregun e sigurimeve në Bashkimin Evropian, si dhe mund të japë zgjidhje nevojave të të siguruarve. Një tjetër çështje ishte edhe ajo e diskriminimit në sigurime, roli i ndërmjetësve dhe zbatimi i tyre

në zhvillimin e mëtejshëm të ligjit të kontratave, si dhe tema mbi avokatin financiar, një raport empirik mbi rolin e tij dhe zhvillimet gjatë 2012. Dëshmëpërblimet kolektive, gjendja e tyre aktuale, si dhe rruga e cila duhet ndjekur për të vazhduar përpara, ishte tema e cila u diskutua në përfundim të konferencës.

Koordinimi i politikave dhe stabiliteti financiar

Qendra e Ekselencës Financiare (ECF) e Ministrisë së Financave, Slloveni zhvilloi gjatë periudhës 28-30 mars 2012, në Slloveni takimin mbi koordinimin e politikave dhe stabiliteti financiar.

Objekti kryesor i programit ishte trajtimi i çështjeve të qëndrueshmërisë financiare nga pikëpamja e koordinimit të politikave ndërmjet tri institucioneve qendrore të ekonomisë në çdo vend: banka qendrore, autoriteti i mbikëqyrjes financiare dhe ministria e financave. Prezantimet u bënë nga ekspertë të Bankës Qendrore Evropiane, Bankës Qendrore të Hungarisë dhe Bankës Qendrore të Holandës. Prezantimet trajtonin përvojën e vendeve evropiane mbi masat e marra, në disa prej tyre, lidhur me ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare. Në to u trajtuan elementët e masave mbikëqyrëse në nivel mikro dhe makro dhe si po veprohet në klasifikimin e drejtë të tyre; nevojën për përfshirjen në legjislacion të një përkufizimi sa më të qartë mbi

qëndrueshmërinë financiare, me qëllim që të mund të qartësohet përgjegjësia në ndjekjen e këtij objekti; analizën e qëndrueshmërisë financiare dhe sfidat për të, si dhe ndërhyrjet me paketat e masave për rivendosur qëndrueshmërinë financiare. Vend të rëndësishëm, në prezantimet, zinin zhvillimet si pasojë e krizës globale.

Prezantimi teorik u shoqërua me studimin e një rasti praktik. Objektivat e trajtimit të rastit konkret ishin aftësimi për të analizuar nga pikëpamja makro situatën ekonomike dhe identifikuar rreziqet për qëndrueshmërinë financiare; aftësimi për të bashkërenduar veprimet ndërmjet bankës qendrore, autoritetit të mbikëqyrjes financiare dhe ministrisë së financave në përpjekje për të shmangur rreziqet që kërcënojnë qëndrueshmërinë financiare të vendit ose për të minimizuar ndikimet e tyre, si dhe konkludimin e paketave të masave që konsiderohen efektive për kapërcimin e situatave problematike.

Bazat e Marrëveshjes së Përgjithshme të Tregtisë në Shërbime

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës zhvilloi gjatë periudhës 27-28 mars, seminarin mbi Bazat e Marrëveshjes së Përgjithshme të Tregtisë

në Shërbime. Të gjithë vendet anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë, OBT, janë gjithashtu palë nënshkruese e kësaj marrëveshjeje dhe marrin përsipër të

gjithë angazhimet përkatëse që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Ekspertë të OBT-së referuan mbi parimet dhe elementet kryesore të marrëveshjes së përgjithshme të tregtisë së shërbimeve dhe njohjen me procesin e negociimeve për nënshkrimin e marrëveshjes së OBT-së. Pjesëmarrës në seminar ishin edhe përfaqësues nga Kosova, megjithëse ata nuk e kanë nënshkruar marrëveshjen.

Kjo temë ishte me interes për palën kosovare, pjesëmarrëse në seminar, si palë që akoma nuk e ka nënshkruar këtë marrëveshje.

Gjatë seminarit u trajtuan tema të tilla, si: historiku i marrëveshjes së përgjithshme të tregtisë së shërbimeve, eksperiencia deri në ditët e sotme dhe struktura themelore e marrëveshjes, si dhe shqyrtimi i detajuar i strukturës së marrëveshjes së përgjithshme të tregtisë së shërbimeve dhe angazhimet specifike të ndërmarra.

Në seminar u vu theksi mbi detyrimet bazë që secili shtet duhet të ketë parasysh në ndërtimin e skedulit të angazhimeve specifike, duke marrë në shqyrtim raste të veçanta, sidomos për sektorë si shëndeti publik, bankat dhe telekomunikacioni.

TË REJA NGA RAJONI

Sloveni: Reflektime mbi Tregun e sigurimeve gjatë 2011

www.xprimm.com

Efektet e krizës ekonomike ndihen edhe në industrinë e sigurimeve gjatë vitit 2011 në 19 shoqëritë e sigurimit, anëtarë të Shoqatës së Kompanive të Sigurimit. Gjatë 2011, kanë gjeneruar 2.092 mld Euro në prime të shkruara bruto, ose 0.12% më pak krahasuar me vitin 2010, kryesisht për shkak të rënies së sigurimit të Jetës.

Në bazë të klasave të sigurimit, primet e shkruara bruto të Jo-Jetës, zënë rreth 1.45 mld Euro, një rritje e ngadaltë me rreth 1.1% krahasuar me 2010 dhe duke përfaqësuar 69.5% të totalit të primeve të sigurimeve në tregun sloven. Në sigurimin e Jo-Jetës peshën më të madhe e zënë klasat e sigurimit të shëndetit (428.5 mln Euro), TPL e brendshme (283.4 mln Euro), Kasko (254.5 mln Euro) dhe

sigurimi i pronës (zjarri dhe rreziqet shtesë dhe dëmtime të tjera në pronë) me një prim të shkruar bruto prej 241.6 mln Euro, e cila pati një rënie prej 16.7% krahasuar me vitin 2010 dhe një rënie prej 11.6% të totalit të tregut.

Primi i shkruar bruto i sigurimit të Jetës pësoi një rënie prej 2.71% me një total prej 638.2 mln Euro, me një peshë prej 30.5% të primeve në totalin e tregut.

Sipas Shoqatës së Kompanive të Sigurimit të Sllovenisë, një tjetër arsye e rëndësishme për rënien e sigurimeve të Jetës ishte ajo “statistikore”, si pasojë e një ndryshimi në anëtarësinë e shoqatës. Numri i shoqërive anëtare nuk ka ndryshuar, por agregati i primeve nga sigurimi i jetës është zvogëluar.

Gjatë 2011, kanë gjeneruar 2.092 mld Euro në prime të shkruara bruto, ose 0.12% më pak krahasuar me vitin 2010, kryesisht për shkak të rënies së sigurimit të Jetës.


Rumani: Sigurimi i Jetës dhe i Pronës dinamikë pozitive gjatë 2011

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës kapën një vlerë prej 6.2 mld RON (monedha rumune), duke treguar një rënie nominale në Euro prej 8%.

Në fund të vitin 2011 tregu rumun i sigurimeve arriti rreth 7.8 mld Euro prime të shkruara bruto. Krahasuar me 2010, shifrat e vitit të kaluar tregojnë një rënie nominale prej 6.9%, duke treguar një zbutje të mundshme të trendit rënës, e cila kishte filluar në vitin 2009.

Ndarja e Portofoleve 2011



Midis klasave të rëndësishme në portofolin e tregut, sigurimi i Jetës dhe i pronës ishin të vetmet klasa, që tregonin një dinamikë pozitive, të cilat në fakt ngadalësuan rënien e totalit të primeve bruto. Këto klasa pritet që të udhëheqin rritjen në vitin 2012, vit në të cilin siguruesit presin që të arrijnë një rritje modeste pozitive. Nëse pritsshmëritë e tyre do dalin të sakta, ndoshta viti 2012 do të jetë fillesa e një rikuperimi të tregut.

Primi i shkruar bruto i sigurimit të Jetës u rrit me 3.1%, me një vlerë prej 398.4 mln EUR. Produktet tradicionale të sigurimit të Jetës zënë një peshë prej 63% të primeve të shkruara bruto në këtë treg, duke fituar një pikë përqindje.

Sigurimet e mjeteve motorike, sërish në rënie

Primet e shkruara bruto për sigurimin e

Jo-Jetës kapën një vlerë prej 6.2 mld RON (monedha rumune), duke treguar një rënie nominale në Euro prej 8%. Sigurimi i mjeteve motorike regjistroi një ndryshim negativ të agregatit nominal vit pas viti me pothuajse 20%. Sigurimi i kaskos pati një rënie prej 18.5%, ndërsa për sa i përket klasës së TPL së brendshme pati një rënie mbi 21%. Në total, sigurimi motorik arriti në 940.8 mln EUR, nga të cilat 475 mln EUR erdhi nga klasa e sigurimit kasko.

Klasa e sigurimit të pronës në vitin 2011 ishte klasa më e mirë për siguruesit rumunë. Me një rritje 18.6% nga viti në vit, ky sektor arriti të ketë rreth 308.7 mln EUR dhe një peshë 16.6% të totalit të portofolit të tregut.

Dëmet e paguara nga siguruesit rumunë arritën vlerën prej 1 mln Euro, 17% më pak se në 2010. Sigurimi i Jo-Jetës zë 98% të totalit të dëmeve të paguara. Si zakonisht, sigurimi i mjeteve motorike është burimi kryesor i dëmeve, me peshë rreth 85% të dëmeve të Jo-Jetës. Të dhënat për dëmet e paguara motorike në vitin 2011 janë pothuajse 13% më pak se në 2010.

Në 2011, ndërmjetësit realizuan rreth 39.05% të totalit të primit të shkruar bruto, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me 38.5% në vitin 2010. Megjithatë, duke folur në terma absolute, volumi i primit të shkruar bruto nëpërmjet ndërmjetësimit kapi vlerën prej 732.4 mln Euro, 3.6% më pak se në vitin 2010.

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, T. Baleta, A. Dervishi, E. Valera, E. Sherri, M.Vaska, F. Broqi, R. Eltari, E. Beqir-Aga, E. Kokona

Të dhënat për dëmet e paguara motorike në vitin 2011 janë pothuajse 13% më pak se në 2010.